

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta dhe Enver Peci, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve I.B. dhe F.B., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 179 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa i pandehuri E.M., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 388 par.2 nënpar.2.1 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit E.M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda DKR.PP.nr.187/2016 të datës 14.3.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.582/2017 të datës 24.3.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.4.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit E.M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda DKR.PP.nr.187/2016 të datës 14.3.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.582/2017 të datës 24.3.2017.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin DKR.PP.nr.187/2016 e datës 14.3.2017, të pandehurve I.B. dhe F.B, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 179 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, iu ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj, e cila do t'iu llogaritet nga data 19.3.2017 deri me 19.5.2017, ndërsa të pandehurit E.M., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 388 par.2 nënpar.2.1 lidhur me par.1 të KPK, u ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj, e cila do t'iu llogaritet nga data 18.3.2017 deri me 18.5.2017. Masa e paraburgimit u është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.2, të KPPK-së.

*Vendimi i Gjykatës së Apelit*

Kundër këtij aktvendimi ankesë kanë paraqitur mbrojtësit të pandehurve, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr.582/2017 e datës 24.3.2017, ka refuzuar si të pabazuara ankesat dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

*Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.*

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit E.M., av. B.L., për shkak të cenimit të nenit 5.1, 5.3 dhe 5.4 të Konvetës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, lidhur me nenin 441 të KPPRK, shkeljes se parimeve themelore të KPPRK, lidhur me paraburgimin nga neni 5 par.3 ( parimi - gjykimi i drejtë dhe i paanshëm ) neni 12 par.1 dhe 2 ( parimi i ligjshmërisë së privimit nga liria ), shkeljes esenciale të dispozitave procedurale nga neni 384 par.1 pika 1.10 të KPPRK, shkeljes së dispozitave të nenit 190 par.2 nënpar.2.1 të KPPRK, neni 192 par.1 par.3 nënpar. 3.1 dhe 3.2, par.4 nënpar.4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të KPPRK, lidhur me nenin 161 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 KPRK dhe neni 415 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4 të KPRK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimet e atakuara t'i ndryshojë dhe të pandehurin E.M., ta lirojë që të mbrohet në liri gjatë procedurës penale ose masën e paraburgimit t'ia zëvendësojë me ndonjë masë tjetër.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi kryesisht thekson se arsyet e dhëna nga dy gjykatat e instancave më të ulëta janë krejtësisht të pabazuara dhe të paqëndrueshme dhe në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë kërkesën e as nevojën për vazhdimin e paraburgimit, se për veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer i pandehuri është paraparë dënimi me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet çka do të thotë që paraburgimi ndaj tij nuk është obligator dhe se para ngritjes së aktakuzës, në bazë të nenit 190 par.2.1, gjyqtari nuk mund të urdhërojë paraburgimin në kohëzgjatje prej më shumë se 4 muaj, se standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e parasheh paraburgimin si mjet i fundit dhe më të rëndë për sigurimin e prezencës së të dyshuarit, dhe i cili duhet të jetë për një periudhë sa më të shkurtër, se nuk është argumentuar në asnjë mënyrë dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet dhe nuk ka prova të cilat e argumentojnë këtë, se të pandehurit i dihet vendbanimi, si dhe në një pjese të konsiderueshme të kërkesës ka shpjeguar lidhur me kërkesën tij për përjashtimin e prokurorit të rastit z.Agim Kurmehaj dhe e gjithë PTH në Pejë me kërkesë që ky rast t'i besohet Prokurorisë Speciale të Kosovës.

*Opinioni i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.23/2017 e datës 14.4.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

## *Gjetjet e Gjykatës Supreme*

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase në këtë çështje penalo - juridike nga shkresat e lëndës, kryesisht nga kallëzimi penal 2014-DA-3448 i datës 20.10.2016, procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurit I.B. 2014-DA-3448 i datës 18.06.2016, dy procesverbalet e marrjes në pyetje të pandehurit E.M. 2014-DA-3448 të datave 18.10.2016 dhe 19.10.2016, procesverbalet mbi identifikimin e personit përmes fotografisë 2014-DA-3448 i datës 18.10.2016 dhe deklaratat e dëshmitarëve, si dhe provat tjera të mbledhura gjer më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryrës i veprës penale për të cilën dyshohet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK ngase është e bazuar frika se i pandehuri, nëse ndodhet në liri mund të arratiset, të gjejë mënyrat për t'u fshehur dhe për t'i ikur përgjegjësisë penale, duke pasur parasysh faktin se për veprën penale për të cilën dyshohet janë paraparë dënime mjaft të larta dhe në këtë mënyrë do të pengoi rrjedhën normale të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ndikimit në dëshmitarët (që supozohet se janë një numër i madh), ngase në këtë çështje penale janë të përfshirë disa të pandehur tjerë të cilët janë familjarë, dhe mund të ndikojnë tek njëri - tjetri me qëllim të koordinimit të deklaratave apo të favorizimit të ndonjërit në procedurën penale, duke pas parasysh se hetimet ende nuk kanë përfunduar.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se për veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer i pandehuri është paraparë dënimi me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet, çka do të thotë që paraburgimi ndaj tij nuk mund të zgjasë më shumë se 4 muaj sipas nenit 190 par.2 nënpar.1 të KPPK ( para ngritjes të aktakuzës paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se katër (4) muaj kur procedura zbatohet për veprën penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim), nuk qëndron, ngase ky nen vjen në shprehje për rastet e veprave penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim me më pak se 5 (pesë) vjet, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me një vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në 5 (pesë) vjet, pra mund t'i shqiptohet edhe dënimi me 5 (vjet) burgim.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se, në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.93/2017, më datë 19.04.2017

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka